



PROJEKTI PËR MBËSHTETJEN E PARLAMENTIT SHQIPTAR

Faza e 2-të, 2007-2010

Financuar nga Holanda, bashkëfinancuar dhe zbatuar nga OSBE

Përmbledhje e Programit

Projekti për Mbështetjen e Parlamentit Shqiptar, Faza II ngrihet mbi punën e bërë dhe në arritjet e fazës së parë të mbështetjes që i është dhënë Kuvendit të Shqipërisë falë financimit Hollandez (780 000 Euro) për një projekt të zbatuar nga Prezenca e OSBE-së gjatë periudhës Dhjetor 2001 – Dhjetor 2006.

Duke u bazuar në objektivat për reformë të evidentuara nga vetë Parlamenti, faza e dytë e Projektit është ndërtuar për të kompletuar buxhetin e Kuvendit me burime shtesë (granti total i qeverisë Hollandeze prej 1.2 milion Euro, kontributi i OSBE-së prej 135 000 Euro) dhe për të siguruar ekspertizën dhe trajnimin e nevojshëm në fushat e rëna dakord bashkarisht. Si i tillë, është menduar që projekti të arrijë rezultate të qëndrueshme dhe afatgjata duke qenë se pjesët kryesore të projektit janë mbështetur drejtpërsëdrejti edhe nga planet e brendshme të Kuvendit. Projekti do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë midis Kuvendit dhe Prezencës.

Qëllimi i përgjithshëm është që me mbështetjen e Projektit dhe duke u bazuar në vetë programin e Kuvendit të arrihet në krijimin e një:

- *Institucioni më efektiv* që të mund të përmbushë rolin e tij kushtetues si një forum i debatit politik dhe një mekanizëm për mbikqyrjen dhe kontrollimin e qeverisë;
- *Institucioni më profesionist*, personeli i të cilit është i kualifikuar dhe i mirë-trajnuar;

- *Institucioni më transparent*, funksionimi i të cilit është i hapur për shqyrtim dhe bën të mundur që puna e tij të vihet në dispozicion të publikut;
- *Institucioni më reagues*, i cili nëpërmjet rritjes së transparencës merr parasysh opinionin publik dhe mund të reagojë ndaj interesave të shprehur kolektivisht të qytetarëve të cilëve duhet t'u shërbejë;
- *Institucioni që do të fuqizojë pjesëmarrjen e grave në Kuvend*. Në përpjekjen për të rritur rolin e grave në jetën politike shqiptare, ky Projekt do të ketë për qëllim kryerjen e aktiviteteve të veçanta për të ndihmuar deputetet femra, punën për të promovuar barazinë gjinore dhe për të shtuar një dimension gjinor në aktivitetet e tjera.

Projekti, kryesisht i financuar nga Qeveria Hollandeze, është parashikuar që të zgjasë për periudhën 2007 – 2010. Projekti është i përbërë prej 6 pjesësh kryesore:

- 1 Mbështetje për struktura drejtuese të modernizuara në menaxhim dhe vendim-marrje;
- 2 Mbështetje për komisione më efektive dhe profesioniste;
- 3 Mbështetje për zyra deputetësh (në rrethe) më aktive dhe më profesioniste;
- 4 Mbështetje për transparencë më të madhe të Kuvendit dhe disponibilitet të informacionit parlamentar;
- 5 Modernizimi i bibliotekës së Kuvendit; dhe
- 6 Krijimi i një programi për praktika studentore.

1. Përforcimi i strukturave drejtuese dhe vendimmarrëse

Projekti mbështet Kuvendin për të zhvilluar më mirë termat e referencës, përshkrimet e punës dhe procedurat e brendshme sipas Rregullores së re. Kjo do të shoqërohet me dhënie të këshillave të vazhdueshme dhe me ndihmë ndaj Kryetarit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe me mbështetje për përmirësimin e menaxhimit dhe planifikimit. Shumë struktura, si Byroja dhe sekretariatet janë të reja dhe nuk kanë terma reference të detajuara për të udhëhequr funksionimin e tyre përtej rolit të përgjithshëm të sqaruar në Rregullore. Duhet gjithashtu që pas një periudhe tre-vjeçare të zbatimit të Rregullores të bëhet një ri-vlerësim, për të përcaktuar në qoftë se duhet bërë ndonjë përshtatje ose "akordim" pas shqyrtimit të efikasitetit dhe zbatueshmërisë së saj.

Më tej, projekti do të mbështesë Kuvendin në:

1. Zhvillimin e Manualit për deputetët
2. Rishikimin/përditësimin e përshkrimeve të punës së personelit
3. Zhvillimin e një sistemi transparent promovimesh
4. Zhvillimin e një Manuali të Procedurave Standarde Operuese për personelin
5. Sigurimin e mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin e një kapaciteti të brendshëm trajnues
6. Përmirësimin e planifikimit të buxhetit të brendshëm të Kuvendit

2. Zhvillimi i komisioneve

Me zhvillimin e parlamenteve, komisionet e tyre bëhen vendi ku kryhet pjesa më e madhe e punës dhe ku merret pjesa më e madhe e vendimeve. Në mënyrë që të kemi komisione më efektive dhe profesioniste, projekti do të sigurojë trajnim, ekspertizë dhe ndihmë për të zgjeruar funksionimin e tyre përtej rolit të tyre aktual të kufizuar. Meqë legjislacioni shqiptar po bëhet më kompleks, në bazë të kërkesave të procesit të integritetit evropian, Anëtarët e Kuvendit që shërbejnë në komisione do kenë nevojë të specializohen dhe gjithashtu të mbështeten në personelin e mirëtrajnuar dhe të specializuar të komisionit. Ndihmë e



mëtejshme do të sigurohet veçanërisht për komisione si atë të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, atë të Sigurisë Kombëtare, për Komisionin e Integritetit Evropian dhe Nënkomisionin për Minorenët dhe Mundësi të Barabarta.

Trajnimi i personelit të komisioneve

Vëmendja kryesore e këtyre aktiviteteve do të fokusohet mbi personelin mbështetës të komisioneve. Nevojiten përmirësime për të përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo pjesëtar të personelit të komisionit. Shpeshherë, detyrat ndahen në mënyrë jo eficiente midis sekretarëve të komisionit dhe këshilltarëve. Gjithashtu, ndihma e grupit kërkimor të Bibliotekës për komisionet nuk është gjithmonë e qartë. Nevojitet trajnim i mëtejshëm për të ndihmuar sekretarët në përgatitjen e proces-verbaleve dhe përdorimin e pajisjeve të reja dhe për t'u ardhur në ndihmë këshilltarëve në përvetësimin e metodave kërkimore.

Vendosje e komunikimit mes Komisioneve dhe publikut të gjerë

Projekti, gjithashtu, do të ndihmojë komisionet në punësimin e këshilltarëve nëse shihet e nevojshme, për të zhvilluar veprimtari për afrimin me publikun dhe vizita në terren dhe për të inkurajuar seanca më të shpeshta dëgjimore. Grupi aktual i kryetarëve të komisioneve ka propozuar lloje të ndryshme veprimtarish, të cilat padyshim do t'i bëjnë më të shumëllojshme aktivitetet e komisioneve dhe do të fuqizojnë rolin e tyre mbikëqyrës.

Mbikëqyrja Parlamentare mbi organet që raportojnë dhe informojnë Kuvendin

Një vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të Kuvendit dhe komisioneve të tij në mbikëqyrjen e atyre institucioneve të krijuara me ligj, si dhe organeve kushtetuese të cilat i raportojnë Kuvendit apo e informojnë atë. Në mënyrë që të zhvillohet një koncept i qartë në lidhje me rolin dhe përgjegjësitë e Kuvendit dhe komisioneve ndaj këtyre institucioneve, si dhe me qëllim rritjen e kapaciteteve kërkimore dhe ekspertizës së Kuvendit, Projekti do të mbështesë Kuvendin në vlerësimin e marrëdhënieve me organet në fjalë për të bërë të mundur një mbikëqyrje më efektive si nga ana procedurale ashtu edhe strukturore.

Integrimi Evropian

Pas rishikimit të strukturës ekzistuese, do të jepet ndihmë për të fuqizuar kapacitetin kërkimor duke u përqendruar kryesisht në trajnime të detajuara mbi çështjet e Integrimit Evropian, si dhe në forcimin e kapaciteteve të Kuvendit, në miratimin e legjislacionit që i përmbush plotësisht standardet evropiane dhe mban parasysh *acquis communautaire*.

3. Zyra deputetësh më aktive dhe më profesioniste

Njëqind deputetë nga 140 që ka Kuvendi, zgjidhen drejtpërsëdrejti me anë të garës në mazhoritar. Duhet që këta deputetë të kenë zyra në zonat e tyre për të qenë pranë elektoratit dhe për të krijuar një lidhje ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale. Rregullat për funksionimin e këtyre zyrave si dhe fondet e kufizuara financiare në dispozicion e bëjnë të vështirë që deputetët të kenë atë shkallë përfaqësimi dhe shërbimi që kërkohet. Projekti po punon me Kuvendin për të përmirësuar ligjin për statusin e deputetit. Me anë të zgjerimit të projektit pilot të nisur që në Fazën e I-rë të Projektit Parlamentar, në Fazën e II-të, Projekti do të mbështesë një numër më të madh zyrash deputetësh dhe personel më të kualifikuar të tyre.

4. Transparencë më e madhe

Rritja e transparencës për mënyrën se si funksionon Kuvendi dhe hapja e tij ndaj publikut është pranuar të jetë një element kyç i reformës parlamentare. Kryetarja aktuale është zotuar të përmirësojë marrëdhëniet e Kuvendit me publikun. Rregullorja e re thekson rëndësinë e transparencës duke bërë të detyrueshme që Kuvendi të përgatisë dhe të vërë në dispozicion në kohën e duhur zbardhjen e diskutimeve të seancave plenare dhe proces-verbalet e mbledhjeve të komisioneve në mënyrë që publiku dhe mediat të mund të shikojnë përmbajtjen e debateve të ligjvënësve në Kuvend.

Në mënyrë që të përmirësohet transparenca e Kuvendit dhe disponibiliteti i informacionit parlamentar, ky Projekt mbështet Kuvendin në përmirësimin e infrastrukturës fizike të tij, si dhe në teknologjinë e informacionit (IT). Projekti siguron mbështetje për Kuvendin në zhvillimin e një baze të dhënash që do të përmbajë të gjithë dokumentacionin për legjislacionin, rezultatet e votimeve dhe seancat e pyetjeve dhe përgjigjeve dhe do të jetë i disponueshëm si në intranet (rrjetin e brendshëm) ashtu edhe për publikun.

Parashikohen gjithashtu një sërë aktiviteteve publike, të cilat kanë për qëllim afrimin e Kuvendit me publikun dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në seancat parlamentare.



5. Biblioteka

Biblioteka dhe Shërbimi Kërkimor i Kuvendit përdoret si nga deputetët ashtu edhe nga personeli. Megjithatë titujt dhe materialet kërkimore në të mbeten të kufizuara.

Duke qenë se çështjet me të cilat merret Kuvendi vazhdojnë të bëhen gjithnjë e më komplekse, duhet që biblioteka të zgjerohet përsa i përket titujve/librave dhe shërbimeve që ofron për t'u vënë në dispozicion përdoruesve informacion të përditësuar në shumë fusha si dhe në gjuhë të tjera përveç shqipëse. Edhe infrastruktura e përgjithshme e bibliotekës ka nevojë për përmirësime.

Për të modernizuar bibliotekën, projekti është në kërkim të një marrëveshjeje dypalëshe me një parlament kombëtar evropian që ka një shërbim të konsoliduar bibliotekar dhe dokumentues për të projektuar hapësirën fizike të bibliotekës, për të zgjeruar numrin e titujve aktualë si dhe materialet referuese multimedia, për të rritur aksesin në burimet elektronike, kapacitetin e personelit kërkimor, për të ofruar trajnime dhe shërbime shtesë, dhe të gjitha këto me qëllimin që të zgjerohet baza e përdoruesve të rregullt.

6. Praktika studentore

Duke patur parasysh kufizimet buxhetore të Kuvendit, nuk ka personel ndihmës të mjaftueshëm për të gjithë komisionet atëherë kur nevojiten. Si një mënyrë për të shtuar personel të kualifikuar (përsa i përket aftësive gjuhësore, njohjes së kompjuterit dhe njohurive teknike) dhe pa shtuar kostot, Projekti bashkëpunon me Kuvendin për të zhvilluar një program praktikash studentore me Kuvendin.

Studentët përfitojnë nga eksperienca e punës në një ambient unik, qoftë duke punuar me komisionet, grupet parlamentare apo me administratën. Qëllimi është që të zhvillohet një program i suksesshëm i praktikës studentore i përballueshëm nga vetë Kuvendi gjatë vitit të tretë e në vazhdim.



Përveç punës që do të kryejnë për Kuvendin, studentët praktikantë do të ndjekin një takim të përmuajshëm, i cili përfshin seminarë trajnues për aftësitë në punë dhe raporte të studentëve për ecurinë e tyre. Seminarët kualifikues mund të organizohen nga partnerë të tjerë të projektit.

7. Ekipi i Projektit

Johan Hommes, *Drejtor i Projektit*

Tel +355 68 206 9918

E-mail: johan.hommes@osce.org

Miranda Ostrosi, *Kordinatore Kombëtare*

Tel +355 69 209 0117

E-mail: miranda.veliaj@osce.org

Saimira Nazifi, *Asistente*

Email: saimira.nazifi@osce.org